



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

---

Numri i lëndës: 2023:274203

Datë: 13.03.2024

Numri i dokumentit: 05442746

**C.nr.4687/23**

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil,** gjyqtarja Edije Sezairi, me bashkëpunëtorin profesional K.R. në çështjen juridike kontestimore të paditëseve A.E.B. me numër personal të identifikimit .... dhe M.Th. me numër personal të identifikimit .... të dyja nga Prizreni, të cilat me autorizim i përfaqëson avokat V.H. nga Prizreni, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit, Drejtoria Komunale e Arsimit, Prizren, me objekt të kontestit kompensimi i të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit, vlera e kontestit 1.494 euro, jashtë seancës gjyqësore, më datë **12.03.2024**, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**  
**pa shqyrtim kryesor të çështjes**

**I. APROVOHET në tërësi e bazuar** kërkesëpadia e paditëseve A.E.B. dhe M.Th. që të dyja nga Prizreni, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit, Drejtoria Komunale e Arsimit, Prizren, për shkak të kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit.

**II. DETYROHET** e paditura Komuna e Prizrenit, Drejtoria Komunale e Arsimit, Prizren, që paditëseve, në emër të kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit, ti paguaj shumat si në vijim:

- Paditëses A.E.B. nga Prizreni, për periudhën kohore prej datës 15.11.2021 deri më datë 06.02.2023 apo për 15 muaj (për çdo muaj shumën prej 55.35 euro, në shkallë prej 27% të pagës bazë- 421.00 euro, në emër të diferencës së papaguar të kualifikimit ose licencimit), t'ia paguajë shumën prej 830.25 euro, me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, nga dita e parashtrimit të padisë me datë 11.12.2023 e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm;
- Paditëses M.Th. nga Prizreni, për periudhën kohore prej datës 24.02.2022 deri më datë 06.02.2023 apo për 12 muaj (për çdo muaj shumën prej 55.35 euro, në shkallë prej 27% të pagës bazë- 421.00 euro, në emër të diferencës së papaguar të kualifikimit ose licencimit), t'ia paguajë shumën prej 664.2 euro, me kamatë ligjore prej 8% në nivel

vjetor, nga dita e parashtrimit të padisë me datë 11.12.2023 e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbartimit të detyrueshëm;

**III. DETYROHET** e paditura, që paditëseve, t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 134.00 euro, në afat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbartimit të detyrueshëm.

### **A r s y e t i m**

Paditëset A.E.B. dhe M.Th. që të dyja nga Prizreni, të cilat sipas autorizimit i përfaqëson avokat V.H. nga Prizreni, pranë kësaj gjykate kanë parashtruar padi, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit, Drejtoria Komunale e Arsimit, Prizren, me objekt të kontestit kompensimi i të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit, vlera e kontestit 1.494 euro.

Në padi, palët paditëse kanë theksuar se janë të punësuar si mësimdhënëse pranë ShFMU "Brigada 125" në fshatin Medvec, Komuna e Prizrenit, ku vazhdojnë të punojnë në këtë institucion, si dhe janë të kualifikikuara me diplomë fakulteti e të cilave në bazë të Vendimit nr.01/33 të datës 29.08.2008 të Qeverisë së Republikës së Kosovës iu është garantuar e drejta në pagesën shtesë mbi pagën bazë, varësisht nga kualifikimi, me çka paditësve iu është paguar kjo shtesë nga e paditura vetëm pjesërisht, respektivisht iu është paguar shuma prej 58.32 euro nga gjithsej 113.67 euro sa u takon. Tutje kanë theksuar se paditëset realizojnë pagën bazë në shumën prej 421 euro, ashtu që në bazë të kualifikimit universitar ju takon shuma prej 27% e pagës bazë, respektivisht paditëses A.E.B. për periudhën prej datës 15.11.2021 e deri më 06.02.2023, për gjithsej 15 muaj nuk i është paguar shuma prej 55.35 euro në muaj, e që shuma e papaguar është në 830.25 euro, ndërsa për paditësen M.Th. për periudhën kohore prej 24.02.2022 e deri më datë 06.02.2023 për gjithsej 12 muaj nuk i është paguar shuma prej 55.35 euro në muaj, e që shuma e papaguar është në 664.20 euro. Andaj, ka propozuar që të aprovohet e bazuar kërkesëpadija e paditëseve, të detyrohet e paditura t'iu kompensojë shumën që u takon në emër të kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit, me kamatë ligjore prej 8% dhe të detyrohet e paditura që t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore.

E paditura, në përgjigjen në padi e ka kontestuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditëseve si të pa bazuar, duke kërkuar që gjykata të njëjtën ta refuzoj si të pabazuar. Ka theksuar se pretendimi i paditëseve se i takon kompensimi për licencim është në kundërshtim me nenin 2 par. 1.1 të Kontratës Kolektive të Arsimit, sepse në atë dispozitë shkruan se përfitues të të gjitha beneficioneve që rrjedhin nga Kontrata Kolektive e Arsimit janë vetëm për anëtarët e Sindikatës së Arsimit – SBASHK-ut, ndërsa paditëset nuk ka paraqitur fakte se është anëtar i kësaj sindikate, nuk ka dëshmuar me anë të kartelës së anëtarësisë. Po ashtu ka theksuar se paditëset ka ushtruar padi në gjykatë për realizimin e të drejtave pa përfunduar procedura administrative, sepse nuk i ka vazhduar procedurat në Inspektoratin e Punës në Prizren, që do të thotë se paditëset nuk i ka shterur të gjitha mjetet juridike në procedurën administrative, ashtu që i janë drejtuar gjykatës në kundërshtim me nenin 124 par. 6.1. të Ligjit për Procedurën Administrative, dhe me këto veprime të paditurës i shkaktojnë shpenzime të mëdha, sepse obligohen të paguajnë edhe shpenzimet e procedurës gjyqësore. Sa i përket obligimit lidhur me përmbushjen e detyrimit, e paditura në përgjigjen në padi thekson se vet Komuna e Prizrenit nuk është nënshkruese e Kontratës Kolektive, përkatësisht Qeveria e Republikës së Kosovës është garantues i implementimeve të KKAK-së, andaj Komuna e Prizrenit nuk ka kod buxhetor

për përmbushjen e obligimeve që burojnë nga KKAK-ja. Me të gjitha të cekurat si më lartë, e paditura ka kërkuar që kërkesëpadia e paditëseve të refuzohet në tërësi si e papabuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 152 të LPK-së, gjeti se kërkesëpadia e paditëseve është në tërësi e bazuar, andaj pa shqyrtim të çështjes, e aprovoi kërkesëpadinë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Ndërmjet palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestues fakti se paditëset A.E.B. dhe M.Th. janë në marrëdhënie pune tek e paditura, si mësimdhënëse pranë ShFMU “Brigada 125” në Medvec, Komuna e Prizrenit. Mirëpo, kontestuese ishte nëse paditëseve u takon e drejta e kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit, përkatësisht diferencës konkrete të papaguar.

Në këtë drejtim, gjykata nga kontrata e punës nr.64/21 të datës 04.10.2021 e lidhur ndërmjet paditëses A.E.B. dhe të paditurës, rezulton se kualifikimi i paditëses është kualifikim universitar, respektivisht e njëjta ka të përfunduar fakultetin e Edukimit, fakt i cili vërtetohet edhe nga Diploma me numër 1307 e datës 13 shtator 2019 e lëshuar nga Universiteti “Ukshin Hoti” në Prizren, Fakulteti i Edukimit, në emër të paditëses, nga ku ka marrë titullin bachelor e programit fillor, ndërsa bazuar nga lista e pagave të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës, vërtetohet se lartësia e pagës bazë të paditëses A.E. është në shumë prej 421.00 euro dhe se paditëses në emër të kualifikimit fakultet, në pagën bazë mujore i është paguar shuma prej 58.32 euro.

Gjykata nga kontrata e punës nr.65/21 të datës 04.10.2021 e lidhur ndërmjet paditëses M.Th. dhe të paditurës, rezulton se kualifikimi i paditëses është kualifikim universitar, respektivisht e njëjta ka të përfunduar fakultetin e Edukimit, fakt i cili vërtetohet edhe nga Diploma me numër 459 e datës 24 tetor 2016 e lëshuar nga Universiteti “Ukshin Hoti” në Prizren, Fakulteti i Edukimit, në emër të paditëses, nga ku ka marrë titullin bachelor e matematikë – informatikë, ndërsa bazuar nga lista e pagave të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës, vërtetohet se lartësia e pagës bazë të paditëses A.E. është në shumë prej 421.00 euro dhe se paditëses në emër të kualifikimit fakultet, në pagën bazë mujore i është paguar shuma prej 58.32 euro.

Provat e lartcekura, gjykata i pranoi si provë materiale vendimtare, në kuptim të nenit 329 par. 1 të LPK-së, sipas së cilës dispozitë ligjore përcaktohet se “shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”. Andaj meqë këto dokumente janë të pranueshme edhe për vetë palën e paditur, pasi që të njëjtat nuk janë kontestuar, gjykata ia fali besimin e plotë.

Gjykata gjen se në rastin në fjalë zbatohen dispozitat e Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33 të datës 29.08.2008. Kështu, në pikën 1. të këtij vendimi, përcaktohet që “nga 1 shtatori 2008 të gjithë mësimdhënësit, drejtorët (zëvendësdrejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional në shkollat e Republikës së Kosovës, do të kenë rritje të pagave të tyre në bazë të kritereve të licencimit”. Ndërsa, në pikën 4. të vendimit në fjalë parashihet ngritja e pagës sipas shkallës apo nivelit të kualifikimit ose licencimit, në të cilën përcaktohet se “mësimdhënësit, drejtorët (zëvendësdrejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional, të pajisur: 1). Me diplomë të Shkollës Normale përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 10%; 2). Me diplomë të Shkollës së Lartë Pedagogjike përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 19%; 3). Me diplomë universitare 3 dhe

4 vjet përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 27% dhe 4). Me diplomë të ciklit të dytë dhe të tretë (Magjistraturë dhe Doktoraturë) përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 35%”. Pastaj, bazuar në mendimin juridik nr. 214/2023 të datës 09.10.2023, në pikën I. të tij përcaktohet që “për kërkesat e mësimdhënësve për kompensim mbi bazën e kualifikimit (licencimit), kompensimi bëhet sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara me Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33, datë 29.08.2008”, vendim i cili ka qenë në fuqi deri më 06.02.2023.

Në rastin konkret, gjykata gjeti se e paditura ka për detyrim, që paditëseve t’ia bëjë kompensimin mbi bazën e kualifikimit ose licencimit, konform detyrimeve që rrjedhin nga Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33, datë 29.08.2008, sipas shkallës apo nivelit të kualifikimit ose licencimit të përcaktuar në këtë vendim. Më konkretisht, nga listat e pagave të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës dhe kontrata e punës nr. 64/21 të datës 04.10.2021 për paditësen A.E.B. dhe kontratës nr.65/21 të datës 04.10.2021 për paditësen M.Th. rezulton se e paditura, në emër të kualifikimit apo licencimit në pagën bazë, paditëseve iu ka paguar shumën prej 58.32 euro. Sipas pikës 4 nën pikës 3 të Vendimit nr.01/33 të datës 29.08.2008, paditëset përfiton ngritje prej 27% të pagës bazë, që në rastin konkret paditëset përfiton ngritje në pagën bazë, në emër të licencimit apo kualifikimit shumën prej 113.67 euro. Andaj, gjykata vendosi si në pikën nën I. dhe II. të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke e detyruar të paditurën që paditëses A.E.B. për çdo muaj t’ia paguaj shumën prej 55.35 euro apo diferencën për 15 muaj nga data 15.11.2021 e deri më datë 06.02.2023, në shumë të përgjithshme prej 830.25 euro, ndërsa paditëses M.Th.për çdo muaj t’ia paguaj shumën prej 55.35 euro apo diferencën për 12 muaj nga data 24.02.2022 e deri më datë 06.02.2023, në shumë të përgjithshme prej 664.20 euro.

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse dhe duke llogaritur kamatën ligjore, bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashtrimit të padisë më datë 11.12.2023, bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditur është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse.

Gjykata me rastin e vendosjes jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në nenin 152 të LPK-së, ku parashihet që “po që se i padituri me anë të përgjigjes në padi i ka pohuar faktet vendimtare, përkundrejt kontestimit të kërkesëpadiisë, gjykata mundet pa caktuar seance gjyqësore, të jep aktgjykim (neni 143 dhe 147 të këtij ligji), nëse nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e tij”.

Lidhur me kundërshtimet tjera të palës së paditur dhënë në përgjigje në padi, gjykata vlerësoi se të njëjtat nuk janë të bazuara në dispozita ligjore dhe nuk kanë mbështetje në ndonjë bazë faktike apo juridike. Rrjedhimisht, gjykata erdhi në përfundim se faktet nuk ishin kontestuese dhe nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e vendimit merititor.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është marrë konform nenit 449 dhe 453 të LPK-së lidhur me nenin 463 par. 1 të LPK-së, duke obliguar të paditurën që në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore, paditëseve t’ia paguajë shumën e përgjithshme prej 134.00 euro, sipas Tarifës së Odës së Avokatëve, për përpilimin e padisë shumën prej 104 euro dhe për taksë gjyqësore shumën prej 30 euro.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, në pajtim me nenin 143 lidhur me nenin 152 të LPK-së.

## **GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**

Numri i lëndës: 2023:274203

Datë: 13.03.2024

Numri i dokumentit: 05442746

**Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil**  
**C.nr.4687/23 të datës 12.03.2024**

**Bashkëpunëtore Profesionale**  
**Kadire Rexha**

**Gjyqtarja**  
**Edije Sezairi**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimi të të njëjtit, pranë Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.